


SHPJEGIMI I TARIFAVE

Çfarë janë tarifatat dhe si funksionojnë ato



Faturat e energjisë elektrike mund të jenë vështirë të kuptueshme edhe për gjërat më të thjeshta, sikurse sa realisht paguajmë ne për energjinë e konsumuar. Çmimi që ju e paguan për energjinë elektrike përbëhet nga këto hapa:

1. **Kostot e prodhimit:** Shpenzimet e prodhimit të energjisë elektrike në centralin elektrik.
2. **Kostot e transmisionit:** Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së gjerë shtetërore për tensionin e lartë
3. **Kostot e shpërndarjes:** Ndërtimi dhe mirëmbajtja e shtyllave dhe kablove elektrike të shtetit të cilat e shpërndajnë energjinë elektrike tek shtëpia dhe biznesi juaj
4. **Kostot me pakicë:** Kyçja e konsumatorëve, menaxhimi i transaksioneve të konsumatorëve.
5. **Kostot shtesë:** Kostot e importit me qëllim të mbulimit të mungesës së prodhimit në vend.



Përbërësit e tarifave


Përbërësit kryesor të tarifave dhe ngarkesave që aplikohen në Kosovë janë si në vijim:

- Ngarkesa për energji (aktive dhe reaktive) - është e aplikueshme për energjinë e konsumuar (të matur) për secilin grup të konsumatorëve
- Ngarkesa për fuqi - është e aplikueshme për kërkesën maksimale të matur (kW) për secilin konsumator gjatë çdo kohe të kërkesës
- Ngarkesa fikse - është e aplikueshme si ngarkesë fikse për secilin konsumator

Struktura tarifore

Struktura aktuale e tarifave për çdo amvisëri, e aprovuar nga ZRRë është e ndarë në tri blloqe:

- **Blloku i parë tarifor** – aplikohet për konsumin mujor deri në 200kWh/muaj
- **Blloku i dytë tarifor** - aplikohet për konsumin ndërmjet 201kWh/muaj dhe 600 kWh/muaj
- **Blloku i tretë tarifor** - aplikohet për konsumin mbi 600 kWh/muaj



"Tarifat në blloqe mund të përdoren për të nxitur konsum efikas. Ato mund të përdoren gjithashtu edhe për arsye sociale, por vetëm në ato rrethana ku rregullatori nuk është i kënaqur, sipas dëshmimeve në dispozicion, që mekanizmat tjerë të subvencionimeve janë duke i mbrojtur drejt konsumatorët e pambrojtur."

Struktura ekzistuese e tarifave për konsumatorët e amvisërisë në Kosovë është e tillë që përpos që është e ndarë në tri blloqe, aplikon çmime të ndryshme për sezonin dimëror dhe sezonin veror, përfshirë dhe konsumin gjatë natës dhe ditës, me qëllim që të reflektojë dallimin e kostove të energjisë elektrike në kohë të ndryshme.

Përveç ngarkesave për konsumin sezonal në sistemin elektrik, ndryshimet në tarifa nodhin edhe mbrenda dite (24 ore). Koha e përdorimit është zakonisht mekanizmi për menaxhimin e kërkesës me qëllim që të zhvendosim një pjesë të konsumit nga 'konsumi i lartë' në 'konsumin e ultë'.

Tarifa/ Sezona	Dimër	Verë
E lartë	07:00 - 22:00	08:00 - 23:00
E ultë	22:00 - 07:00	23:00 - 08:00

Struktura tarifore është në fuqi nga 1 shtatori 2014, bazuar në vendimin e ZRRë Nr. V_645_2014

*Dimër (1 Tetor – 31 Mars) Verë (1 Prill – 30 Shtator)

Grupi tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Sezoni i Lartë 1 tetor - 31 mars	Sezoni i ulët 1 prill - 30 shtator
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator / muaj		2.50	
Amveseri	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.55	3.99
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.79	1.99
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.70	5.51
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.86	2.76
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	11.17	8.00
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.58	4.01

Struktura tarifore për amvisëri, njëhësori 2 shkallor.

• Çmimi për bllokun specifik aplikohet pas shpërndarjes së konsumit në blloqet përkatëse